



Buletini Shkurt 2012 <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 104-Shkurt 2012 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>






Përmbajtja:

Diskutohet gjendja e krijuar nga bora.....	3
Ndihmohen 14 familje në komunën e Malishevës	4
Rrugët e kalueshme me vështirësi.....	4
RAPORT RRETH GJENDJES AKTUALE NË KOMUNËN E MALISHEVËS, PAS TË RESHURAVE TË MËDHA TË BORËS.....	5
Kilaj e Carlier, vlerësojnë lartë bashkëpunimin mes Komunës dhe OSBE-së.....	7
Vlerësohet angazhimi i qeverisë lokale.....	8
Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti mbledhjen e tetëmbëdhjetë	9
Nënshkruhet memorandumi për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal	9
Komiteti për Komunitete mbajti mbledhjen e parë për këtë vit	11
Qeveria Komunale mbajti mbledhjen e rregullt të së hënës	11
KK miratoi raportin e punës së Kryetarit dhe Qeverisë Komunale	12

Diskutohet gjendja e krijuar nga bora

Malishevë, 6 shkurt



Këshilli i Drejtorëve në Komunën e Malishevës, në mbledhjen e saj të rregullt, të udhëhequr nga kryetari Isni Kilaj, ka diskutuar për gjendjen e krijuar nga reshjet e vazhdueshme të borës në dy javët e fundit, ku situatë më e rëndë paraqitet në fshatrat që shtrihen në vargmalet e Berishës.

Fshatrat që shtrihen në këtë pjesë, kanë vështirësi në qarkullim, pasi si pasojë e reshjeve

të vazhdueshme dhe erërave, vazhdimisht po bllokohet rruga, sidomos në fshatrat Berishë dhe Fshat i Ri, ndërsa në pjesët tjera të komunë së Malishevës, rrugët janë kryesisht të kalueshme. Kryetari Kilaj, ka kërkuar nga drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, që të kontaktohen të gjitha vendbanimet dhe të verifikohet me saktësi situata e krijuar ditëve të fundit, dhe për nevojat eventuale të banorëve.

Kilaj, po ashtu ka kërkuar edhe nga drejtoria e Shëndetësisë, që të kontaktohen udhëheqësit e fshatrave që shtrihen në vargmalet e Berishës dhe nëse kanë nevojë për shërbime emergjente mjekësore, të dërgohen ekipet e shërbimit të emergjencës nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, për t'ju dalë në ndihmë banorëve në nevojë.

Po ashtu, në këtë mbledhje u kërkuar dërgimi i makinerisë shtesë për largimin e borës në rrugën që shpie në fshatin Berishë dhe Fshat i Ri.



Si pasojë e kushteve të rënda atmosferike

Ndihmohen 14 familje në komunën e Malishevës

Malishevë, 8 shkurt

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, gjatë dy ditëve të fundit, ka ndihmuar 14 familje me gjëra ushqimore, të cilat ditëve të fundit, janë duke u përballur me probleme si pasojë e kushteve të rënda ekonomike. Gjendja e tyre është rënduar edhe më shumë nga të ftohtit dhe bora e pandërprerë, duke ju pamundësuar atyre lëvizjen për furnizim me gjëra ushqimore.



Dje dhe sot, kryetari Kilaj, ka vizituar personalisht këto 14 familje, në fshatrat Gurbadh, Tërpezë, Turjakë, Drenoc, Lubizhdë, Damanek dhe Senik, familje të cilat paraprakisht kanë kërkuar ndihmë, me c’rast të gjitha këto familjeve, janë furnizuar me gjëra ushqimore, si : miell, krip, vaj dhe gjëra tjera të nevojshme.

“Ndihmat e tilla, do të vazhdojnë edhe ditëve në vijim, varësisht prej kërkesave, nevojës dhe mundësive”, ka thënë midis tjetash kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj.

Rrugët e kalueshme me vështirësi

Malishevë, 13 shkurt



Bora e mbrëmshme ka vështirësuar qarkullimin pothuajse në tërë territorin e Komunës së Malishevës. Sipas zyrtarëve nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim “të gjitha rrugët janë të kalueshme, por me vështirësi, mirëpo është duke u punuar që brenda ditës ato të hapen “. Në anën tjetër edhe kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, ka dalë në teren për të parë nga afër gjendjen e rrugëve dhe nevojat e banorëve.



Ejup Zulfaj, shef në drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, ka konfirmuar, se “janë angazhuar makineri shtesë për hapjen e rrugëve, ndërsa zyrtarët e kësaj drejtorie, edhe gjatë vikendit kanë qenë të angazhuar në këtë aspekt. Rrugët janë të kalueshme me vështirësi, ndërsa prioritet i yni mbetet hapja e rrugëve kryesore, por në orët e pasdites edhe hapja e rrugëve nëpër lagje. Sot, do të zhbllokohen edhe fshatrat në vargmalet e Berishës, si Berisha, Fshati i

Ri, Guncati, Bardhi e Lladroci”, tha Zulfaj.

Për të parë nga afër gjendjen me rrugët, edhe sot, ashtu sikur edhe gjatë tërë javës së kaluar, kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, ka dalë në teren për të parë nga afër edhe nevojat e banorëve të komunës së Malishevës.

Përndryshe, bora e rënë përgjatë këtyre tri javëve, po shkakton vështirësi në qarkullimin e njerëzve, si dhe po vështirëson furnizimin e familjeve me ushqime dhe gjëra tjera të nevojshme.

RAPORT RRETH GJENDJES AKTUALE NË KOMUNËN E MALISHEVËS, PAS TË RESHURAVE TË MËDHA TË BORËS

Malishevë, 14 shkurt



Sa i përket gjendjes së përgjithshme në komunën e Malishevës, pas të reshurave të mëdha të borës, mund të themi se, të gjitha rrugët janë të kalueshme, por me vështirësi, sidomos në fshatrat e vargmaleve të Berishës. Te kjo pjesë e territorit të komunës së Malishevës, tek mbrëmë është arritur mundësia e lidhjes me rrugën kryesore.

Në gjithë këtë situatë, janë të angazhuara makineri shtesë, përveç asaj që kanë qenë e përzgjedhur me tender, për pastrimin e rrugëve nga bora, për ç'gjë komuna ka ndarë 15 mijë euro. Në këtë kontekst ka edhe të atillë që janë lajmëruar vullnetarisht për të pastruar hequr borën, duke kërkuar vetëm heqjen e shpenzimeve të karburanteve.



Për të parë nga afër gjendjen me rrugët dhe situatën e banorëve në përgjithësi, gjatë gjithë këtyre ditëve ka qenë në teren edhe vet kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, dhe ekipe të tjera komunale si ato nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe ajo për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

- Me këtë rast janë ndihmuar me gjëra ushqimore rreth 35 familje, përfshirë këtu edhe dru e gjëra të tjera në këtë kontekst.
- Ekipe të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), kanë dalë në teren, kanë vizituar dhe kanë ndihmuar rastet që kanë kërkuar ndihmë shëndetësore. Gjatë këtyre ditëve janë ndihmuar 13 raste të ndryshme shëndetësore. Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë, Skënder Hoti, ka qenë dhe është në kontakt të vazhdueshëm me kryetarët e fshatrave për tu informuar për raste të tilla.

Megjithatë sot, situata e qarkullimit në komunën e Malishevës, është lehtësuar, por mbetet akoma për tu bërë.

Deri tani nuk ka të raportuara për dëme materiale, përjashtuar mbulojën një fushe(montazhe)futbolli, këtu në qytetin e Malishevës. Ndërkohë që kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka apeluar te qytetarët që t'i bashkëngjiten ekipeve për pastrimin e rrugëve nga bora, si dhe të kenë kujdes në heqjen e borës nga çatitë e shtëpive të tyre.

Kilaj e Carlier, vlerësojnë lartë bashkëpunimin mes Komunës dhe OSBE-së

Malishevë, 16 shkurt

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, sot ka pritur drejtorin regional të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) për regionin e Prizrenit, z.Francis Carlier, dhe me këtë rast është vlerësuar lartë bashkëpunimi mes Komunës së Malishevës dhe OSBE-së.



“Unë ju falënderoj juve dhe OSBE-në për përkrahjen dhe bashkëpunimin e deritanishëm, si për dhënien e këshillave, ashtu edhe për projektet e realizuara në Malishevë”, ka thënë kryetari Kilaj, duke e falënderuar z.Carlier, ndërsa ky i fundit, tha se “niveli i bashkëpunimit mes OSBE-së dhe Komunës së Malishevës, është shumë i mirë, ndërsa kontaktet me komunën janë të përditshme”.

Në këtë takim janë diskutuar disa çështje, ku interesimi i zyrtarit të lartë të OSBE-së, ishte për çështjen e të riatdhesuarve, ndërsa kryetari Kilaj dhe zyrtarja për kthim dhe komunitete znj.Ardita Krasniqi, e kanë informuar drejtorin Carlier, lidhur me personat e riatdhesuar në Malishevë

“Deri më tani janë rikthyer 38 persona dhe të gjitha janë të integruar mirë në shoqëri”, ka thënë zyrtarja Krasniqi, ndërsa kryetari Kilaj, tha se “Pavarësisht prej faktit se jeni një komunë e pazhvilluar në aspektin ekonomik, nuk kemi probleme me personat e riatdhesuar, pasi të gjithë janë të integruar në jetën shoqërore dhe nuk kanë probleme me dokumentacion”.



Drejtori regional i OSBE-së, z.Francis Carlier, e ka informuar kryetarin Kilaj, edhe me projektin e OSBE-së, që janë duke zhvilluar me Këshillat për Veprim Lokal (KVL), ndërsa sipas tij, “prioritet i OSBE-së në këtë projekt është rinia dhe çështjet gjinore”.

Pas të reshurave të mëdha të borës

Vlerësohet angazhimi i qeverisë lokale

Malishevë, 20 shkurt

Në mbledhjen e rregullt të qeverisë së Malishevës, e kryesuar nga kryetari Isni Kilaj, është raportuar për situatën e fundit në komunë, me rastin e të reshurave të mëdha të borës.

Kryetari i Komunës, z. Kilaj, ka vlerësuar angazhimin e qeverisë, anëtarët e së cilës kanë dhënë maksimumin për t’iu dalë në ndihmë qytetarëve.



“Kemi pas vështirësi, por të gjithë kemi qenë të angazhuar, sidomos drejtorët e Drejtorive të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes dhe Shpëtimit. Edhe pse është obligim yni, unë ju falënderoj për angazhimin tuaj, por edhe kompanitë të cilat kanë qenë të angazhuara vazhdimisht për pastrimin e rrugëve nga bora, dhe për ndihmë qytetarëve në vendet më të thella të komunës tonë”, kështu tha mes tjerash kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, duke bërë të ditur po ashtu edhe për angazhimin e tij personal dhe vizitat që i ka bërë në teren gjatë atyre ditëve, me ç’rast ka shpërndarë edhe pako me gjëra ushqimore për familjet të cilat kanë qenë të bllokuara nga bora.

Me këtë rast, është adresuar një falënderim dhe mirënjohje për punëtorët e shëndetësisë, të cilët sipas kryetarit Kilaj, kanë bartur edhe me krahë persona të cilët kanë pas nevojë për ndihmë mjekësore. Njëkohësisht është falënderuar edhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila ka ndihmuar kompanitë me derivate dhe ka shpërndarë pako ushqimore për disa familje me nevoja.



Është raportuar për disa dëme materiale, si çatia të dyqaneve, fusha sporti (montazhe), sera, e që sipas drejtorit për Mbrojtje dhe Shpëtim, Halit Zogaj, në fund të javës do të bëhet një raporti detaj.

Në këtë mbledhje drejtori i Arsimit, z. Isuf Morina, ka bërë të ditur se mësimi ka filluar në të gjitha shkollat e Komunës së Malishevës.

Në fund të takimit, drejtori i Urbanizmit, Esat Paçarizi, gjithashtu ka bërë të ditur se të enjten, datë 23 shkurt, prej orës 10:00-12:00, do bëhet nënshkrimi i memorandumit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal me UN-HABITAT, i financuar nga SIDA- Program për Mbështetje të Komunave për Planifikim Hapësinor (MuSPP), si dhe prezantimi informativ që do të bëhet nga stafi i UN-HABITAT, në lidhje me përvojat me komunat e tjera.

Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti mbledhjen e tetëmbëdhjetë

Malishevë, 21 shkurt

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), ka mbajtur mbledhjen e tetëmbëdhjetë të radhës dhe të dytën për këtë vit, ku janë shqyrtuar dhe janë dhënë tri rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës të Malishevës.

KPF ka rekomanduar për kuvend, Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës dhe të Qeverisë Komunale në Malishevë, për periudhën Janar-Dhjetor 2011, ndërsa me kërkesë të kryetarit, KPF, ka rekomanduar për kuvend, edhe kërkesën për ndarjen e mjeteve për familjet e dëshmorëve, të cilat nuk e kanë të rregulluar statusin e Familjes së Dëshmorit.

Po ashtu me kërkesën e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, është rekomanduar për kuvend edhe bartja e mjeteve nga buxheti i vitit 2011 në buxhetin e vitit 2012.

Nënshkruhet memorandumi për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal

Malishevë, 23 shkurt

Komuna e Malishevës dhe UN-HABITAT-i, sot, kanë nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal. Memorandumi është nënshkruar nga z.Isni Kilaj, kryetar i komunës dhe përfaqësuesi i UN-HABITAT-it, z.Ishaku Miatumba, të cilët e kanë vlerësuar si shumë të rëndësishëm bashkëpunimin për hartimin e këtij plani.



“Në vitin 2004, ne kemi hartuar Planin Zhvillimor për qytetin e Malishevës, ndërsa tani ky plan që do të hartohet, është për tërë territorin e Malishevës, pra për 44 vendbanimet e komunës”, tha kryetari Kilaj, në fjalën e mbajtur, me rastin e nënshkrimit të këtij memorandumi.

“Hartimi i këtij plani është obligim shtetëror, ndërsa plani do të hartohet nga njerëzit tanë, ekspertë të të gjitha

fushave”, tha Kilaj. “Unë e falënderoj UN-HABITAT-in, për ndihmën e dhënë në hartimin e këtij plani”, tha kryetari Kilaj, duke e shpreh falënderimin për mbështetjen e kësaj organizate.

Nga ana tjetër, përfaqësuesi i UN-HABITAT-it, z.Ishaku Miatumba, pasi falënderoi Kryetarin e Malishevës për bashkëpunimin, tha se “Ky memorandum e konfirmon bashkëpunimin me partnerët tanë në Malishevë”. “Ky plan është obligim, por dallimin në Malishevë është se, mënyra e hartimit do të bëhet nga komuna dhe nga njerëzit e saj”, tha Miatumba, i cili në fund, e quajti si “diçka shumë të mirë për Malishevën”.

Pas nënshkrimit të memorandumit dhe fjalimeve të kryetarit Kilaj dhe përfaqësuesit të UN-HABITAT-it, është bërë edhe prezantimi informativ, në lidhje me përvojat nga komunat tjera, pastaj mënyrën e hartimit të këtij plani, fazat dhe aspektin juridik.



Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal me UN-HABITAT-in, është i financuar nga SIDA- Program për Mbështetje të Komunave për Planifikim Hapësinor (MuSPP).

Komiteti për Komunitete mbajti mbledhjen e parë për këtë vit

Malishevë, 24 shkurt

Komiteti për Komunitete, komit obligativ i Kuvendit të Komunës së Malishevës, ka mbajtur sot mbledhjen e parë për vitin 2012, ku janë shqyrtuar disa çështje, si dhe morën vendim për hartimin e planit të punës së komitetit për vitin 2012.

Kryesuesi i komitetit, Hysni Gashi, tha se “është shumë me rëndësi hartimi i këtij plani të punës, pasi do të na ndihmonte për punën tonë dhe bërjen sa më funksional të komitetit, në mënyrë që edhe të mund të kryejmë obligimet tona ndaj komunitetit”.

Me propozimin e anëtarëve tjerë, Komiteti për Komunitete, do të merr për bazë të hartimit të planit, edhe punën e mëhershme të këtij komiteti, në legjislacionet e kaluara, si dhe shkëmbimin e përvojave me komunat tjera në vend.

Me këtë rast, edhe përfaqësuesi i ekipit komunal të OSBE-së, ka ofruar ndihmën e kësaj organizate në hartimin e këtij plani dhe në përgjithësi në punën e komitetit.

Komiteti për Komunitete, është njëri nga dy komitetet obligative që duhet ti formoj Asambleja Komunale.

Qeveria Komunale mbajti mbledhjen e rregullt të së hënës

Malishevë, 27 shkurt



Qeveria Komunale e Malishevës, e udhëhequr nga Kryetari i saj, z.Isni Kilaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt, ku janë diskutuar një varg çështjesh, përfshirë këtu edhe dëmet e shkaktuara nga bora, përgatitjet për festat e Marsit, përgatitjet për masat preventive kundër etheve hemorragjike dhe paraqitja e raportit vjetor të punës para Kuvendit të Komunës.

Sipas drejtorit për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Halit Zogaj, komisioni i formuar nga kjo drejtori ka inspektuar të gjitha rastet e ankesave për dëme nga bora, ku janë regjistruar trembëdhjetë raste si, kulme të shtëpive dhe objekteve përcjellëse, pastaj një fushë e mbuluar e futbollit, ndërsa gjatë ditëve në vijim, do të përfundoj vlerësimi si tërësi.

Ndërsa drejtori për Bujqësi, z.Sinan Kryeziu, ka raportuar për dëmet në bujqësi, kryesisht në serra, ku janë regjistruar dy raste të dëmeve të mëdha, vlera e të cilave është rreth 32 (tridhjetedy) mijë euro, kurse për dëme të tjera në pemë dhe vreshtari, komisioni i kësaj drejtorie, është duke punuar në vlerësimin e tyre.

Në këtë mbledhje, është diskutuar edhe për përgatitjet, për marrjen e masave parandaluese kundër infektimit nga ethet hemorragjike, problem me të cilin është përballur në vazhdimësi territori i Komunës së Malishevës, por falë fushatave të spërkatjeve selektive të zonave endemike, është arritur që vitin e kaluar të mos ketë të regjistruara asnjë rast të infektimit, dhe sipas drejtorit për Shëndetësi, z.Skënder Hoti, “nëse vazhdohet me këtë aksion edhe vitet në vijim, do të eliminohet në tërësi edhe rreziku nga thumbimi i rriqrave”.

Po ashtu, në mbledhjen e sotme, është diskutuar edhe raporti vjetor i punës, i Qeverisë Komunale të Malishevës, raport i cili do të prezantohet para Kuvendit të Komunës, të mërkurën me 29 shkurt, si dhe është diskutuar për përgatitjet e shënimit të festave të Marsit, si “Epopeja e UÇK-së” dhe Dita e Mësuesit.

KK miratoi raportin e punës së Kryetarit dhe Qeverisë Komunale

Malishevë, 29 shkurt



Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur sot, të njëzetekatërtën me rend (e dyta e këtij viti), ka miratuar raportin e punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale, për vitin 2011, si dhe ka marrë tri vendime të tjera.



Raporti i punës së kryetarit dhe qeverisë komunale për vitin 2011, është prezantuar para asamblistëve nga kryetari z.Isni Kilaj, i cili më pas edhe është përgjigjur në të gjitha pyetjet e parashtruara, lidhur me punën për vitin e kaluar. Me kërkesën e këshilltarëve, ky raport është miratuar, me shumicë të votave.

Asambleja Komunale, sot ka miratuar edhe kërkesën e kryetarit, për mbështetje financiare për Familjet e Dëshmorëve, të cilat nuk e kanë të rregulluar statutin e Dëshmorit, ndërsa mbështetja, do të jetë e njëjtë me familjet tjera të dëshmorëve, që e kanë të rregulluar statusin.

Po ashtu në mbledhjen e sotme, KK i Malishevës, miratoi edhe kërkesën e drejtorisë për Buxhet dhe Financa, për bartjen e mjeteve nga viti 2011 në vitin 2012.

Në fund, Kuvendi, miratoi edhe Planin e Punës së Kuvendit, për vitin 2012, plan i hartuar nga komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës.